



## PYETËSORI PËR TË MATUR PERFORMANCËN DHE IMPAKTIN E INOACIONIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË TIRANË

Në kuadër të hartimit të Strategjisë së Inovacionit për Tiranën, Pyetëtori mbi Inovacionin e Brendshëm u hartua nga Drejtoria e Inovacionit me mbështetjen e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtorisë së të Dhënave si instrument për të matur performancën dhe impaktin e digjitalizimeve dhe inovacionit sipas vlerësimit të stafit të Bashkisë Tiranë.

I strukturuar në pyetje të shkurtra dhe përmbledhëse, ai u shpërnda tek strukturat e brendshme të Bashkisë Tiranë.

### Përfshirja

Mostra e sondazhit ishte gjithëpërfshirëse për stafin e Bashkisë Tiranë, njësi administrative si dhe për institucionet në varësi. Përkatësisht:

- 31.9% e të intervistuarve janë pjesë e Njësive Administrative.
- 67.2% e të intervistuarve janë pjesë e Bashkisë Tiranë.
- 0.9% e të intervistuarve janë pjesë e institucioneve në varësi.

### Digjitalizimi

- 75.9% e punonjësve të Bashkisë shprehen se është shumë e rëndësishme për ta që institucioni ku punojnë t'u ofrojë shërbime të digjitalizuara dhe inovative për stafin.
- 58.6% e tyre kanë dijeni për shërbimet e digjitalizuara që Bashkia ofron, ndërkohë 41.4% shprehen se nuk kanë dijeni për shkak të mungesës së informacionit nga drejtuesit e drejtorive apo njësi përkatëse ose puna e tyre nuk i lidh me asnjë shërbim të digjitalizuar.

### Disa nga shërbimet e digjitalizuara që ofron Bashkia Tiranë

- Sistemi **Cloud** - 73.3% e të intervistuarve janë në dijeni.
- Aplikacioni **Vcall** - 26.7% e të intervistuarve janë në dijeni.
- Sistemi i **vlerësimit të performancës** - 86.2% e të intervistuarve janë në dijeni.
- Portali i **listë prezencave** - 51.7% e të intervistuarve janë në dijeni.
- **E-learning** - 38.8% e të intervistuarve janë në dijeni.
- **Opendata** - 37.9% e të intervistuarve janë në dijeni.
- **GIS** - 37.1% e të intervistuarve janë në dijeni.

### Asistenca teknike

- 89.7% e të intervistuarve kanë kërkuar asistencë teknike nga Departamenti i IT dhe 97% e të intervistuarve shprehen të kënaqur me sjelljen e stafit teknik përkatës.
- Gjithashtu 96.3% e stafit bashkiak që ka plotësuar sondazhin, shprehen të kënaqur me kohëzgjatjen e zgjidhjes së problemit si dhe 96.2% e të intervistuarve kanë një kënaqshmëri mbi mesataren për cilësinë e zgjidhjes së problemit.

### Formimi profesional

- Vihet re një kërkesë në rritje për krijimin apo mundësimin nga ana e Bashkisë, të platformave të cilat ndihmojnë në zhvillimin profesional apo personal të individëve,
- 57.8% e tyre përdorin platforma jashtë bashkisë për procesin e punës në bashki, dhe 65.5% e tyre përdorin platforma jashtë bashkisë për edukimin e tyre personal.
- 23.8% e stafit kanë nevojë për formimin dhe edukimin e tyre dhe kanë shprehur interesa për kurse online, trajnime, menaxhim arti, etj.

### Konkluzione

Digjitalizimi dhe efektet e e tij në punë janë vlerësuar pozitivisht nga punonjësit e bashkisë.

78.4% e pjesëmarrësve shprehen se janë përmbushur pritshmëritë e tyre në lidhje me këto digjitalizime.

93.1% e të gjithë të intervistuarve janë të gatshëm të ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me institucionin e Bashkisë Tiranë për digjitalizime të reja.

### Sugjerime

1. Rritja e frekuencës së grumbullimit të feedback mbi nevojat dhe zhvillimet në digjitalizimin e strukturës së institucionit.
2. Shtimi i kapacitetit të platformave aktuale (*Cloud ka nevojë për më shumë hapësire ndërsa Vcall ka nevojë për më shumë mundësi pjesëmarrësish dhe kohë në dispozicion*).
3. Trajnime të herë pas herëshme për stafin në lidhje me këto digjitalizime.
4. Problemet e shtruar duhet të kthehen në zgjidhje që të bëhet e mundur dhe mbarëvajtja e punëve dhe rritja e performances.
5. Investim në pajisje të reja dhe programe të cilat janë të nevojshme për disa pozicione pune.